



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 174

Tiranë – E Premte, 14 Nëntor 2014

## PËRMBAJTJA

Faqe

Ligj nr. 142/2014 datë 23.10.2014	Për disa ndryshime në ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	8659
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 726, datë 2.11.2014	Për miratimin e marrëveshjes së dytë ndryshuese, ndërmjet “Albpetrol”, sh.a.-së, dhe Bankers Petroleum Albania, Ltd, për marrëveshjen hidrokarbure të datës 19 qershor 2004, miratuar me vendimin nr. 477, datë 16.7.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e marrëveshjes për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e Patos-Marinzës”, të ndryshuar	8666



**LIGJ**  
**Nr. 142/2014**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.**  
**61/2012 “PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN**  
**E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, 84, pika 4, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 5, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Në rast të iniciativave për ndryshime ligjore, që kanë për qëllim rritjen e nivelit të taksimit të akcizës, sasia e importit të mallrave të akcizës nga çasti i vendimit të Këshillit të Ministrave për propozimin për rritjen e saj deri në hyrjen në fuqi të ligjit për këtë nivel të akcizës, nuk mund të jetë më e lartë se 5 për qind më shumë se mesatarja mujore e vitit paraardhës, e importuar nga çdo operator i regjistruar në Republikën e Shqipërisë.”.

**Neni 2**

Në nenin 14, pika 1, shkronja “dh” ndryshohet si më poshtë:

“dh) Kur rimbursohet vlera e akcizës së paguar për biokarburantet që përdoren në sektorin e transportit, që prodhohen në Republikën e Shqipërisë nga njësitë për prodhimin e biokarburanteve, sipas përcaktimit të nenit 5 të ligjit nr. 9876, datë 14.2.2008, “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport”, të ndryshuar, në masën e përcaktuar në ligjin e sipërpërcaktuar, për vlerën e detyrimit të paguar që i korrespondon sasisë së produktit bio që gjendet në produktin e deklaruar për konsum, pas konfirmimit nga Laboratori Kimik Doganor.”.

**Neni 3**

Në nenin 87, pika 1, në nënpikat 1.1, 1.2 dhe 1.3 hiqen fjalët “por, për çdo rast, jo më pak se 1 000 000 lekë”.

**Neni 4**

Në nenin 88, pika 1, shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) sa 5-fishi i detyrimeve fiskale që duheshin paguar për këto mallra të akcizës, të prodhuara në mënyrë të padeklaruar dhe të paautorizuar (klandestine). Gjoha, përveç produkteve tërësisht të përfunduara, aplikohet edhe për produktet që mund të përftoheshin nga lëndët e para në përpunim ose në pritje për t’u përpunuar apo që gjenden në mjediset, në fabrikë a në lokalet ku është kryer shkelja.”.

**Neni 5**

Në nenin 88/1, pika 1, shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) gjobë sa 5-fishi i detyrimeve fiskale që duheshin paguar për këto mallra të akcizës, të prodhuara në mënyrë të padeklaruar dhe të paautorizuar (klandestine). Gjoha, përveçse për produktet tërësisht të përfunduara, zbatohet edhe për produktet që mund të përftoheshin nga lëndët e para në përpunim ose në pritje për t’u përpunuar apo që gjenden në mjediset, në fabrikë a në lokalet ku është kryer shkelja.”.

**Neni 6**

Në nenin 89, pika 1, hiqet fjalët “por, për çdo rast, jo më pak se 1 000 000 lekë”.

**Neni 7**

Në nenin 89/1, pika 1, hiqen fjalët “por, për çdo rast, jo më pak se 1 000 000 lekë”.

**Neni 8**

Në nenin 90, pika 1, hiqen fjalët “por, për çdo rast, jo më pak se 1 000 000 lekë”.

**Neni 9**

Në nenin 91, në pikat 4, 5, 6 dhe 8 hiqen fjalët “por jo më pak se 1 000 000 lekë”.

**Neni 10**

Në nenin 91/1, pika 3, hiqen fjalët “por, për çdo rast, jo më pak se 200 000 (dyqind mijë) lekë”.



## Neni 11

Në nenin 96/1 hiqen fjalët “por, për çdo rast, jo më pak se 1 000 000 lekë”.

## Neni 12

Shtojca 1, që i bashkëlidhet ligjit nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij ligji.

## Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
I Ilir Meta

Miraturar në datën 23.10.2014

**SHTOJCA NR. 1**  
**MALLRAT E TATUESHME ME AKCIZË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Kategoria	Kodi NK	Përshkrimi	Shkalla taksimit
	<b>I</b>	<b>KAFE DHE PIJE ENERGJIKE</b>	
C100 Kafe e papjekur	09 01 11 00 09 01 12 00	Kafe jo e pjekur e dekafeinizuar ose jo	0
C200 Kafe e pjekur	09 01 21 00 09 01 22 00	Kafe e pjekur e dekafeinizuar ose jo	60 lekë/kg
C300 Lëkura, lëvoret zëvendësuesit e kafesë	09 01 90	Lëkura dhe lëvoret e kafesë. Zëvendësuesit e kafesë që përmbajnë kafe	50 lekë/kg
C900 Ekstrakte, esenca, koncentrate kafeje dhe përgatitje prej tyre	21 01 11 00 21 01 12 92 21 01 12 98	Ekstrakte, esenca, koncentrate kafeje dhe përgatitje prej tyre (neskafë etj.)	250 lekë/kg kafe
D000	22 02 10 00	Pije energjike	50 lekë/litër
	<b>II</b>	<b>BIRRË, VERË, ALKOOL DHE PIJE ALKOOLIKE</b>	
B000 Birra	22 03	Birrë e bërë nga malto: -nga prodhues vendas e të huaj me sasi më të vogël se 200 000 HL në vit:  Nga prodhues vendas e të huaj me sasi më të madhe se 200 000 HL në vit	360 lekë/HL./shkallë alkoolometrike  710 lekë/HL./shkallë alkoolometrike
W200 Vera e qetë dhe pjetet e qeta të fermentuara	22 04 21 22 04 29 22 04 30 22 04 30 10 22 04 30 96 22 04 30 98  22 05 10 10 22 05 90 10	Verë e qetë dhe musht rrushi; Vermuth e verëra të tjera të përgatitura nga bimë ose substancia aromatizuese; Pije të tjera të fermentuara (p.sh. musht molle, musht dardhe, hydromel); përzierje të pijeve të fermentuara dhe përzierje të pijeve të fermentuara dhe pijeve joalkoolike të pagazuara.	3 000 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike deri në 12,5 gradë dhe 4 000 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike mbi 12,5 gradë



	22 06 00 10 22 06 00 51 22 06 00 59 22 06 00 81 22 06 00 89	- nga prodhues vendas e të huaj me sasi < = 10 000 hektolitër/vit  - nga prodhues vendas e të huaj me sasi > 10 000 hektolitër/vit	10 000 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike deri në 12,5 gradë dhe 12 000 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike mbi 12,5 gradë
W300 Vera spumante, Shampanja dhe pijet e fermentuara dhe të gazuara	22 04 10 22 04 21 06 22 04 21 07 22 04 21 08 22 04 21 09  22 05 10 10 22 05 90 10  22 06 00 31 22 06 00 39	Verërat spumante, Shampanja; Verë ndryshe nga ato të nënkreut 220410, në shishe me tapa “kërpudhë” që lidhet me mbërthyes apo tela; verë e ndërtuar ndryshe me një presion të pranueshëm në sajë të dyoksidit të karbonit. Vermut e verëra të tjera të përgatitura nga bimë ose substanca aromatizuese të një force alkoolike ndaj volumit prej 18% apo më pak. Pije të tjera të fermentuara (p.sh. musht molle, musht dardhe, hydromel); përzierje të pijeve të fermentuara dhe përzierjet e pijeve të fermentuara dhe pijeve joalkoolike të gazuara.	5 200 lekë/HL
I000 Pijet alkoolike të ndërmjetme	22 04 21 85 22 04 21 86 22 04 21 87 22 04 21 88 22 04 21 89 22 04 21 90 22 04 21 91 22 04 21 93 22 04 21 94 22 04 21 95 22 04 21 96 22 04 21 97 22 04 21 98 22 04 29 85 22 04 29 86 22 04 29 87 22 04 29 88 22 04 29 89 22 04 29 90 22 04 29 91 22 04 29 93 22 04 29 94 22 04 29 95 22 04 29 96 22 04 29 97 22 04 29 98 22 05 10 10 22 05 10 90 22 05 90 10 22 05 90 90 22 06 00 10 22 06 00 31 22 06 00 39	Pijet alkoolike të ndërmjetme me një forcë alkooli mbi 15% volum por që nuk e kalon 22% volum; Sipas përcaktimeve të nenit 74 të ligjit.	5 200 lekë/HL



	22 06 00 51 22 06 00 59 22 06 00 81 22 06 00 89		
S200 Pije alkoolike (Spirituos Beverages).	22042192 22042193 22042194 22042195 22042196 22042197 22042198 22042992 22042993 22042994 22042995 22042996 22042997 22042998 22051090 22059090 22060010 22060031 22060039 22060051 22060059 22060081 22060089 22082012 22082014 22082026 22082027 22082029 22082040 22082062 22082064 22082086 22082087 22082089 22083011 22083019 22083030 22083041 22083049 22083061 22083069 22083071 22083079 22083082 22083088 22084011 22084031 22084039	Pije alkoolike; të përfituara nga distilimi i verës së rrushit apo të bërsive të rrushit, whisky, Rum dhe të tjera pije të përfituara nga distilimi i produkteve të fermentuara nga kallami i sheqerit, Gin dhe Geneva, Vodka, likere dhe tonike, Uzo.  - nga prodhues vendas e të huaj me sasi < = 20 000 hektolitër/vit  - nga prodhues vendas e të huaj me sasi > 20 000 hektolitër/vit	65 000 lekë për HL alkool anhidër  84 500 lekë për HL alkool anhidër



	22084051 22084091 22084099 22085011 22085019 22085091 22085099 22086011 22086019 22086091 22086099 22087010 22087090 22089011 22089019 22089033 22089038 22089041 22089045 22089048 22089052 22089054 22089056 22089069 22089071 22089075 22089077 22089078		
S300 Alkooli etilik jo i denatruar	22071000 22089091 22089099	Alkool etilik jo i denatruar i një force alkoolike ndaj volumit prej 80% volum apo më shumë	45 000 lekë për HL alkool anhidër
S400 Alkool etilik i denatruar	22072000	Alkool etilik i denatruar	0 (zero)
S400 Rakia sipas përcaktimeve të nenit 66 të ligjit	22082029	Raki	20 000 lekë për HL alkool anhidër
S500 Produkte të tjera që përmbajnë alkool etilik	Kapitujt 17 deri 22 të NK	Të gjitha produktet që kanë një shkallë alkoolometrike efektive mbi 1,2 % ndaj volumit dhe pavarësisht klasifikimit në sistemin NK, sipas nenit 64 të ligjit	45 000 lekë për HL alkool anhidër
	<b>III</b>	<b>DUHAN DHE NËNPRODUKTET E TIJ</b>	
T300 Puro dhe cigarillos	24 02 10 00	Puro dhe cigarillos që përmbajnë duhan	2 500 lekë/kg
T200 Cigare që përmbajnë duhan	24 02 20	Cigare që përmbajnë duhan	5 500 lekë/1000 copë Nga 1 janar 2016, 6 000 lekë/1000 copë Nga 1 janar 2017, 6 500 lekë/1000 copë



T500 Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani	24 02 90	Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani	2 240 lekë/kg
T400 Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit	24 03	Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit, duhan i homogjenizuar ose i rindërtuar, ekstrakte dhe esenca prej duhani	4400 lekë/kg Nga 1 janar 2016, 5 100 lekë/kg Nga 1 janar 2017, 5 800 lekë/kg
	<b>IV</b>	<b>PRODUKTET ENERGJETIKE</b>	
E200 Vajrat vegjetale dhe shtazore të klasifikuara në krerët 1507 deri 1518 të NK nëse përdoren për ngrohje apo motorë	1507 deri 1518	Vajrat dhe dhjamërat prej kafshëve apo vegjetale dhe produktet prej tyre	Sipas përcaktimeve të neneve 50 e 51 të ligjit
E300 Vajra minerale	27071010 27071090 27072010 27072090 27073010 27073090 27075010 27075090	Produktet e vajrave minerale që i përkasin kodeve NK të kreut 2707	50 lekë/litri
E400	27 10 12 11	Naftë që kërkon një proces specifik përpunimi	50 lekë/litri
E410	27 10 12 41 27 19 12 45 27 10 12 49	Vajra të lehta (benzinë dhe benzol) Benzinë dhe benzol pa plumb, me përmbajtje plumbi jo më tepër se 0,013 gr/litër Me më pak se 95 oktan Me 95-98 oktan Me 98 e më shumë oktan	37 lekë/litri
E420	27 10 12 51 27 10 12 59	Benzinë me plumb, me përmbajtje plumbi më tepër se 0,013 gr/litër Me më pak se 98 oktan Me 98 e më shumë oktan	50 lekë/litri
E430	27 10 19 11 deri 27 10 19 29	Vajguret	20 lekë/litri
	27 10 19 21 deri 27 10 19 25	Karburantet, tip vajguri	20 lekë/litri
E440	27 10 19 31 deri 27 10 19 48	Vajra të rënda (gazoil)	37 lekë/litri
E450	2710 19 51 deri 27 10 19 69	Vajra të rënda si lëndë djegëse (lëndë djegëse, solar, mazut)	37 lekë/kg
E460	2710 20	Biodiesel me vajra nafte	37 lekë/kg



E470	27 10 19 71 deri 27 10 19 99	Vajra lubrifikante dhe vajra të tjera	40 lekë/kg
E471	27109100 deri 27109900	Mbetje vajrash	5 lekë/kg
E472	27 12 10 90	Graso	40 lekë/kg
E480	2713 11 00 2713 12 00	Koks naftë	2 lekë/kg
E490	27 13 20 00	Bitum naftë	5 lekë/kg
E490	27 13 90	Mbetje të vajrave të naftës dhe të mineraleve bituminoze (bitumen)	5 lekë/kg
E491	27 15	Përzierje bituminoze të bazuara në asfaltin natyror, në bitumen e naftës, në katranin mineral, ose në terpentinën e katranit mineral (masticet bituminoze) Vernik Bituminoz (p.sh. asfalto-beton)	5 lekë/kg bitum
E500 Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike	27111211 27111219 27111291 27111293 27111294 27111297 27111310 27111330 27111391 27111397 27111400 27111900	Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike	0 lekë/litri
E600 Hidrokarburet aciklike	2901	Hidrokarburet aciklike	37 lekë/kg
E700 Hidrokarburet ciklike	2902	Hidrokarburet ciklike	37 lekë/kg
E800 Metanol (Alkooli metilik)	29051100	Metanol (Alkooli metilik)	Sipas përcaktimeve të neneve 50 e 51 të ligjit
L000	34 03 19 10 34 03 99 00	Preparate për lubrifikimin e makinerive, pajisjeve dhe automjeteve	40 lekë/kg
L000 Preparatet antiplasëse, frenues oksidimi; Alkibenzenet e përziera	3811 dhe 3817	Preparatet antiplasëse, frenues oksidimi, stabilizator rrëshire, përmirësues viskoziteti, kundër korrozionit, dhe elemente shtesë të përgatitura për vajrat minerale (përfshirë benzinën) apo lëngje të tjera të përdorura për qëllime të tjera si vajrat minerale Alkibenzenet e përziera dhe Alkinaftalenet e përziera	Sipas përcaktimeve të neneve 50 e 51 të ligjit
E920 Biodiezel	3826 00	Acidet yndyrore /Biodiezel me më pak se 70% vajra naftë të kapitullit 27	37 lekë/litri





	V	FISHEKZJARRËT	
F000 Fishekzjarrët	36 04 10 00	Fishekzjarrët	200 lekë/kg
F000	36 04 90 00	Të tjera	200 lekë/kg
	VI	GOMAT	
P100 Goma të reja	40 11	Goma të reja pneumatike prej gome	20 lekë/kg
P200 Goma të riveshura	40 12 (përveç 40 12 20 00)	Goma pneumatike të riveshura; goma mishi apo të zakonshme; veshja e jashtme (pjesa me lule) dhe fashetat e gomës	40 lekë/kg
P300 Goma të përdorura	40 12 20 00	Goma pneumatike të përdorura	100 lekë/kg
	VII	PILAT DHE BATERITË PRIMARE; AKUMULATORËT ELEKTRIKË	
A100 Pilat dhe bateritë primare	85 06	Pilat dhe bateritë primare	200 lekë/kg
A200 Akumulatorët	85 07	Akumulatorët elektrikë, përfshi ndarëset e tyre, nëse janë apo jo drejtkëndëshe (përfshi katrorët)	20 lekë/kg
	VIII	LLAMBA INKANDESHENTE	
Y100 Llambat inkadeshente	85 39 22 10 85 39 22 90 85 39 29 92 85 39 29 98	Llambat reflektor Të tjera Më tepër se 100 V Jo më tepër se 100 V	100 lekë/copa 100 lekë/copa 100 lekë/copa 100 lekë/copa

**VENDIM**

Nr. 726, datë 2.11.2014

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË DYTË NDRYSHUESE, NDËRMJET “ALBPETROL”, SHA-SË, DHE BANKERS PETROLEUM ALBANIA, LTD, PËR MARRËVESHJEN HIDROKARBURE TË DATËS 19 QERSHOR 2004, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 477, DATË 16.7.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN E HIDROKARBUREVE NË VENDBURIMIN E PATOS-MARINZËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 13, të ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993, “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e marrëveshjes së dytë ndryshuese, ndërmjet “Albpetrol”, sh.a.-së, dhe Bankers Petroleum Albania, Ltd, për marrëveshjen hidrokarbure të datës 19 qershor 2004, miratuar me vendimin nr. 477, datë 16.7.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e marrëveshjes për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e Patos-Marinzës”, të ndryshuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**



**MARRËVESHJA E DYTË NDRYSHUESE  
MIDIS ALBPETROL SHA DHE BANKERS  
PETROLEUM ALBANIA LTD  
NË LIDHJE ME MARRËVESHJEN  
HIDROKARBURE DATË, 19 QERSHOR  
2004, PËR ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN  
EHIDROKARBUREVE NË VENDBURIMIN  
PATOS-MARINZË-SHQIPËRI**

Kjo Marrëveshje e Dytë Ndryshuese (referuar këtu me poshtë si “Marrëveshja e Dytë Ndryshuese”) është hartuar dhe nënshkruar sot më 2 shtator, 2014 nga dhe midis Albpetrol sh.a. (referuar këtu me poshtë si “Albpetrol”) dhe Bankers Petroleum Albania Ltd. (referuar këtu me poshtë “Kontraktori”). Albpetrol dhe Kontraktori këtu me poshtë dotë quhen “Palët”.

*Meqenëse një marrëveshje* hidrokarbure në datën 19 qershor 2004 (referuar këtu me poshtë si “Marrëveshja Hidrokarbure Bazë”) është lidhur ndërmjet Albpetrol dhe Saxon International Energy Ltd. (tani Bankers Petroleum Albania Ltd.) dhe është miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë nr. 477, datë 16 korrik 2004;

*Meqenëse Marrëveshja Hidrokarbure Bazë* lidhet me Licencë-Marrëveshjen (“Licencë-Marrëveshja Bazë”) për Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në vendburimin Patos-Marinzë, datë 7 qershor 2004 midis Ministrisë së Industrisë dhe Energjisë (tani Ministria e Energjisë dhe Industrisë), përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Hidrokarbureve (tani Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe referuar më poshtë si “AKBN”) dhe Albpetrol;

*Meqenëse Kontraktori* u bë palë në Licencë-Marrëveshjen Bazë nëpërmjet një instrumenti transferimi në datë 19 qershor 2004, që është lidhur nga dhe midis Ministrisë së Industrisë dhe Energjisë, përfaqësuar nga AKBN, Albpetrol dhe Kontraktori;

*Meqenëse disa dispozita* të Marrëveshjes Hidrokarbure Bazë janë ndryshuar nga një marrëveshje ndryshuese (referuar këtu me poshtë si “Marrëveshja e Parë Ndryshuese”), datë 8 dhjetor 2008, e cila është lidhur nga dhe midis Albpetrol dhe Kontraktorit dhe miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë nr. 251, datë 12 mars 2009;

*Meqenëse Marrëveshja Hidrokarbure Bazë*, me

ndryshimet përkatëse sipas Marrëveshjes së Parë Ndryshuese, referohet këtu e më poshtë si “Marrëveshja Hidrokarbure”;

*Meqenëse disa dispozita të Licencë-Marrëveshjes Bazë* janë ndryshuar nga Licencë-Marrëveshja Plotësuese (referuar këtu e më poshtë si “MPLM e Parë”), datë 8 dhjetor 2008, e cila është lidhur nga dhe midis Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë, përfaqësuar nga AKBN, Albpetrol dhe Kontraktori;

*Meqenëse Licencë-Marrëveshja Bazë* me ndryshimet sipas MPLM së Parë referohet këtu e më poshtë si “Licence Marrëveshja”;

*Meqenëse Parlamenti i Republikës së Shqipërisë* ka miratuar ligjet në vijim: (1) ligji nr. 10458, datë 21.7.2011, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, me ndryshime”, Fletore Zyrtare nr. 107, publikuar më 9 gusht 2011; (2) ligji nr. 178/2013, datë 28.12.2013, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, Fletore Zyrtare nr. 203, publikuar më 30 dhjetor 2013; dhe (3) ligji nr. 180/2013, datë 28.12.2013, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë””, Fletore Zyrtare nr. 203, publikuar më 30 dhjetor 2013 (bashkërisht “Ndryshimet Fiskale AKQ”);

*Meqenëse Kontraktori* ka të drejtën ekskluzive të kryejë operacione hidrokarbure dhe të prodhojë hidrokarbure në zonën e projektit të përcaktuar në Marrëveshjen Hidrokarbure dhe Licencë-Marrëveshje;

*Meqenëse Palët* njohin se zbatimi i ndryshimeve fiskale AKQ kërkon ndryshimin e Marrëveshjes Hidrokarbure në përputhje me nenin 18.3 të Marrëveshjes Hidrokarbure, në mënyrë që të ruhen përfitimet ekonomike të Kontraktorit nga Marrëveshja Hidrokarbure, në përputhje me paragrafin 3(d) të nenit 5 të ligjit për hidrokarburet nr. 7746, datë 28.07.1993;

Atëherë, Palët bien dakord të ndryshojnë disa dispozita të nenit 1, nenit 9, nenit 13, nenit 14 dhe të neneve 2 dhe 4 (të aneksit B) të Marrëveshjes Hidrokarbure.



## Neni 1 Objekti

1.1 Objekti i kësaj Marrëveshjeje të Dytë Ndryshuese është eliminimi i efekteve ekonomike negative të shkaktuara ndaj Kontraktorit për shkak të Ndryshimeve Fiskale AKQ.

## Neni 2 Përkufizimet dhe interpretimi

2.1 Termat dhe përkufizimet e përdorur në këtë Marrëveshje të Dytë Ndryshuese do të kenë të njëjtin kuptim sipas përcaktimeve të bëra në Marrëveshjen Hidrokarbure, dhe në nenin 1 të Marrëveshjes Hidrokarbure do të bëhen këto shtesa si më poshtë:

“Taksa e karbonit” nënkupton taksën e karbonit të vendosur me ligjin “Për taksat kombëtare”.

“Taksa e qarkullimit” nënkupton taksën e qarkullimit të vendosur me ligjin “Për taksat kombëtare”.

“Pjesa AKQ” ka kuptimin e dhënë në nenin 9.2.

“Rregullimet e Ndryshimeve Fiskale AKQ” ka kuptimin e dhënë në nenin 13.5.

“Ndryshimet fiskale AKQ” do të thotë: (1) ligji nr. 10458, datë 21.7.2011, “Për ndryshimet dhe shtesat në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, me ndryshime”, Fletore Zyrtare nr. 107, publikuar më 9 gusht 2011; (2) ligji nr. 178/2013, datë 28.12.2013, “Për ndryshimet dhe shtesat në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare””, Fletore Zyrtare nr. 203, publikuar më 30 dhjetor 2013; dhe (3) ligji nr. 180/2013, datë 28.12.2013, “Për ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, Fletore Zyrtare nr. 203, publikuar më 30 dhjetor 2013.

“Ligji për akcizat” nënkupton ligjin nr. 61/2012, i ndryshuar, përfshirë ndryshimin e bërë me ligjin nr. 180/2013, datë 28.12.2013.

“Taksa e akcizës” nënkupton taksën e akcizës të vendosur me ligjin për akcizat.

“Ligji për taksat kombëtare” nënkupton ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, i ndryshuar, përfshirë ndryshimin e bërë me ligjin nr. 10458, date 21.7.2011 dhe ligjin nr. 178/2013, datë 28.12.2013.

2.2 Marrëveshja e Dytë Ndryshuese, së bashku me Marrëveshjen Hidrokarbure, përshkruan termat dhe kushtet që rregullojnë operacionet

hidrokarbure në zonën e kontratës ose në çdo pjesë të saj sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, dhe të drejtat e detyrimit e parashikuara këtu dhe në Marrëveshjen Hidrokarbure.

2.3 Pranohet dhe bihet dakord që të drejtat dhe detyrimit e palëve në lidhje me hidrokarburet do të rregullohen nga dispozitat e Marrëveshjes Hidrokarbure me ndryshimet sipas kësaj Marrëveshjeje të Dytë Ndryshuese.

2.4 Të gjitha dispozitat e Marrëveshjes Hidrokarbure, me ndryshimet sipas kësaj Marrëveshjeje të Dytë Ndryshuese, miratohen dhe konfirmohen, dhe do të mbeten në fuqi dhe efekt të plotë, duke marrë parasysh që në rast të ndonjë mospërputhjeje me Marrëveshjen Hidrokarbure, dispozitat e Marrëveshjes së Dytë Ndryshuese do të mbizotërojnë mbi ato të Marrëveshjes Hidrokarbure.

2.5 Referenca të nenet dhe paragrafët e Marrëveshjes Hidrokarbure, bëhet në lidhje me tekstin e Marrëveshjes Hidrokarbure Bazë e datës 19 qershor 2004, sipas ndryshimeve të bëra me Marrëveshjen e Parë Ndryshuese.

## Neni 3

### Neni 9 i Marrëveshjes Hidrokarbure

3.1 Titulli i nenit 9 të Marrëveshjes Hidrokarbure fshihet dhe zëvendësohet si në vijim:

**“Nafta e disponueshme, pjesa e Albpetrol, taksa e rentës minerare, pjesa AKQ, nafta për mbulimin e kostove hidrokarbure dhe nafta fitim”**

3.2 Paragrafi i parë dhe tabela në nenin 9.2 të Marrëveshjes Hidrokarbure ndryshohet si në vijim:

Në fillim të paragrafit të parë të nenit 9.2 të Marrëveshjes Hidrokarbure, do të shtohen fjalët:

“Nga data 1 prill, 2008, deri më datë 31 dhjetor, 2013,”

Tabela pas paragrafit të parë në nenin 9.2 të Marrëveshjes Hidrokarbure, emërtohet “TAB 1 - Tabela e alokimit të naftës së disponueshme për periudhën nga 1 prill, 2008, deri me 31 dhjetor, 2013”.

Në përmbajtjen e tabelës “TAB1 - Tabela e alokimit të naftës së disponueshme për periudhën nga 1 prill, 2008, deri më 31 dhjetor, 2013”, në kolonën “Periudha”, në rreshtin e dytë të kësaj kolone, togfjalëshi “20 gusht 2008 - Përfundim i Marrëveshjes” zëvendësohet me togfjalëshin “20 gusht 2008 - 31 dhjetor 2013”.



3.3 Pas tabelës “TAB1 - Tabela e alokimit të naftës së disponueshme për periudhën nga 1 prill, 2008, deri më 31 dhjetor, 2013” të nenit 9.2 të Marrëveshjes Hidrokarbure, të shtohet paragrafi dhe tabela në vijim:

Nafta e disponueshme do të matet në pikën e

“TAB2 - Tabela e alokimit të naftës së disponueshme për periudhën nga 1 janar, 2014, deri në datën e mbylljes së Marrëveshjes Hidrokarbure”

Periudha	Faktori R	Taksa e rentës minerare	Pjesa Albpetrol	Pjesa AKQ	Naftë për mbulim kosto hidrokarbure
1 janar 2014- Përfundimi i Marrëveshjes Hidrokarbure	$R < 1.0$	10%	1%	X	$100\% - (10\% + 1\% + x)$
	$1.0 \leq R < 1.5$	10%	3%	X	$100\% - (10\% + 3\% + x)$
	$1.5 \leq R < 2.0$	10%	4%	X	$100\% - (10\% + 4\% + x)$
	$R \geq 2.0$	10%	5%	X	$100\% - (10\% + 5\% + x)$

3.4 Paragrafi në vijim do të shtohet në nenin 9.2 të Marrëveshjes Hidrokarbure menjëherë para paragrafit që fillon me shprehjen “Faktori R llogaritet si më poshtë:”

Pjesa e taksës së akcizës taksës së karbonit dhe taksës së qarkullimit (Pjesa AKQ)

Kontraktori do të ketë të drejtën e pjesës AKQ që të rikuperojë Rregullimet e Ndryshimeve Fiskale AKQ që i lindin atij në lidhje me kryerjen e operacioneve hidrokarbure. Rregullimet e Ndryshimeve Fiskale AKQ do të përlogariten në përputhje me nenin 13.5.

Kontraktori do të rikuperojë të gjitha Rregullimet e Ndryshimeve Fiskale AKQ sipas Marrëveshjes Hidrokarbure nga njëqind për qind (100%) e naftës së disponueshme pasi të zbritet taksa e rentës minerare dhe pjesa e Albpetrol.

Një shumë e barabartë me Rregullimet e Ndryshimeve Fiskale AKQ do të përfshihet në kostot hidrokarbure.

3.5 Pas paragrafit që fillon me togfjalëshin “Faktori R llogaritet si më poshtë:”, në nenin 9.2 të Marrëveshjes Hidrokarbure, do të bëhen këto ndryshime:

Paragrafi “AK është shuma e të ardhurave të Kontraktorit minus taksën e fitimit hidrokarbur gjatë tremujorit kalendarik N dhe të gjithë tremujorëve të tjerë kalendarikë paraardhës që vijnë mbas Datës Efektive.” zëvendësohet me paragrafin si më poshtë:

“AK është shuma e të ardhurave të Kontraktorit minus taksën e fitimit hidrokarbur

matjes dhe do të alokohet sipas kësaj Marrëveshje. Nafta e disponueshme do të alokohet midis Qeverisë së Shqipërisë (Taksa e Rentës Minerare), Albpetrol (Pjesa Albpetrol), Kontraktori (“Pjesa AKQ” dhe “Hidrokarbure për Mbulim Kosto”) siç përcaktohet në tabelën në vijim:

gjatë tremujorit kalendarik N dhe të gjithë tremujorëve të tjerë kalendarikë paraardhës që vijnë mbas Datës Efektive, duke shtuar edhe vlerën e pjesës AKQ për të gjithë tremujorët kalendarikë.”

Neni 4

### Neni 13 i Marrëveshjes Hidrokarbure

4.1 Neni 13.2 i Marrëveshjes Hidrokarbure ndryshohet duke zëvendësuar togfjalëshin “Nenin 13.1” me togfjalëshin “Nenin 13.1, 13.5”.

4.2 Pas nenit 13.4 të Marrëveshjes Hidrokarbure shtohet një nen i ri 13.5, me përmbajtje si vijon:

“13.5 Rregullimet e Ndryshimeve Fiskale AKQ Taksa e akcizës

a) Neni 10, paragrafi “3/dh” i ligjit për akcizat parashikonte përjashtime nga taksa e akcizës për importimin e nënprodukteve të naftës (për nevojat e veta, nga subjektet e kërkimit të naftës dhe të vënies në shfrytëzim të zonave naftëmbajtëse, në rast të plotësimit të kushteve specifike, sipas legjislacionit dhe marrëveshjeve për këtë qëllim), që përdoren në operacionet hidrokarbure.

Ndryshimet Fiskale AKQ e kanë shfuqizuar këtë përjashtim nga taksa e akcizës duke filluar nga 1 prill 2014. Si rezultat i këtij shfuqizimi:

i) Kontraktori është i detyruar të paguajë taksën e akcizës sipas ligjit për akcizat në para (*cash*) tek autoritetet doganore për importin e mallrave që i nënshtrohen taksës së akcizës, në përputhje me ligjin shqiptar; dhe

ii) një shumë të barabartë me vlerën e taksës së akcizës e paguar nga Kontraktori pas datës 1 prill



2014 sipas pikës (i) më lart për importimin e nënprodukteve të naftës të përdorura në operacionet hidrokarbure: (A) do të alokohet tek Kontraktori nga nafta e disponueshme; dhe (B) do të përfshihet si kosto hidrokarbure, si pjesë përbërëse e Rregullimeve të Ndryshimeve Fiskale AKQ.

Taksa e karbonit dhe taksa e qarkullimit

b) Taksa e karbonit dhe taksa e qarkullimit u vendosën dhe u ndryshuan, sipas ligjit për taksat kombëtare. Si rezultat i këtyre ndryshimeve:

i) Për çdo taksë karboni që Kontraktori është përgjegjës për të paguar tek: (1) autoritetet doganore për importin e mallrave që i nënshtrohen taksës së karbonit; ose (2) furnizuesve vendas për blerje brenda vendit të mallrave që i nënshtrohen taksës së karbonit, sipas ligjit për taksat kombëtare, një shume të barabartë me diferencën midis vlerës së kësaj takse karboni të paguar nga Kontraktori në lidhje me operacionet Hidrokarbure me vlerën e taksës së karbonit që Kontraktori do të paguante bazuar në nivelin e taksës së karbonit në Datën Efektive të Marrëveshjes Hidrokarbure: (A) do të alokohet tek Kontraktori nga nafta e disponueshme; dhe (B) do të përfshihet si kosto hidrokarbure si pjesë përbërëse e Rregullimeve të Ndryshimeve Fiskale AKQ.

ii) Për çdo taksë qarkullimi që Kontraktori është përgjegjës për të paguar tek: (1) autoritetet doganore për importin e mallrave që i nënshtrohen taksës së qarkullimit; ose (2) furnizuesve vendas për blerje brenda vendit të mallrave që i nënshtrohen taksës së qarkullimit, sipas ligjit për taksat kombëtare, një shumë të barabartë me vlerën e kësaj takse qarkullimi e paguar nga Kontraktori në lidhje me operacionet hidrokarbure: (A) do të alokohet tek Kontraktori nga nafta e disponueshme; dhe (B) do të përfshihet si kosto hidrokarbure si pjesë përbërëse e Rregullimeve të Ndryshimeve Fiskale AKQ.

iii) Ky paragraf (b), i nenit 13.5, të Marrëveshjes Hidrokarbure, do të zbatohet vetëm për ato vlera të taksës së karbonit, dhe/ose taksës së qarkullimit që Kontraktori ka paguar dhe/ose do të paguajë nga data 1 janar, 2014, deri në mbyllje të kësaj Marrëveshjeje Hidrokarbure.”

4.3 Pas nenit 13.5 të Marrëveshjes Hidrokarbure shtohet një nen i ri 13.6, me përmbajtje si vijon:

### 13.6 Deklarime

a) Kontraktori deklaron se, me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Dytë Ndryshuese, është eliminuar çdo efekt ekonomik negativ i ardhur si pasojë e ndryshimeve në legjislacion (Ndryshimet Fiskale AKQ). Për këtë arsye, Kontraktori deklaron se në asnjë rast, nuk do të aplikojë pranë autoriteteve përkatëse për rimbursim të këtyre taksave (Rregullimet e Ndryshimeve Fiskale AKQ). Shkelja e kësaj dispozite do të konsiderohet si shkelje materiale thelbësore e detyrave dhe detyrimeve të Kontraktorit sipas Marrëveshjes Hidrokarbure.

b) Pavarësisht dispozitës së paragrafit 13.6.(a), këtu më sipër, në rast se ndonjë vlerë e taksave që është përfshirë si pjesë përbërëse e Rregullimeve të Ndryshimeve Fiskale AKQ, rimbursohet dhe/ose dëmshpërblehet në favor të Kontraktorit, nga autoritetet përkatëse, atëherë vlera përkatëse e rimbursuar dhe/ose e dëmshpërblyer: (A) do të shtohet në vlerën e naftës për mbulim kosto hidrokarbure; dhe (B) do të zbritet nga vlera e kostove hidrokarbure. Në zbatim të këtij paragrafi, do të kryhet rillogaritja e faktorit R dhe rillogaritja e naftës fitim.

Neni 5

### Neni 14 i Marrëveshjes Hidrokarbure

5.1 Neni 14.1 i Marrëveshjes Hidrokarbure ndryshohet duke shtuar në fillim të fjalisë shprehjen:

“Me përjashtim të taksave të përcaktuara në nenin 13.5,”.

Neni 6

### Neni 2 dhe neni 4 i aneksit B të Marrëveshjes Hidrokarbure

6.1 Paragrafi i parë i nenit 2.10 të aneksit B të Marrëveshjes Hidrokarbure fshihet dhe zëvendësohet me paragrafin e mëposhtëm:

“Të gjitha taksat, detyrimet doganore, tarifat, përfshirë sa më poshtë:

a) një shumë të barabartë me atë pjesë të taksës së rentës minerare të paguar me para (*cash*) Qeverisë Shqiptare nga Kontraktori, siç parashikohet në nenin 9.2 të Marrëveshjes Hidrokarbure;

b) një shumë të barabartë me Rregullimet e Ndryshimeve Fiskale AKQ, siç parashikohet në nenin 9.2 të Marrëveshjes Hidrokarbure, por duke përjashtuar:



c) Tatimi mbi fitimin, i rregulluar sipas nenit 13.1 të Marrëveshjes Hidrokarbure, nëse ka; dhe

d) Pjesa e Albpetrol, siç përcaktohet në nenin 9.2 të Marrëveshjes Hidrokarbure.

6.2 Në nenin 2.10 të aneksit B të Marrëveshjes Hidrokarbure, pas paragrafit që fillon me “Për sqarime të mëtejshme”, shtohet një paragraf, me përmbajtje si më poshtë:

“Për sqarim të mëtejshëm, një shumë e barabartë me 100% të Rregullimeve të Ndryshimeve Fiskale AKQ, siç përcaktohet në nenin 9.2 të Marrëveshjes Hidrokarbure do të përfshihet si kosto hidrokarbure. Shtimi i Rregullimeve të Ndryshimeve Fiskale AKQ si Kosto Hidrokarbure (e kombinuar me zbritjen e pjesës AKQ nga nafta e disponueshme siç parashikohet në nenin 9.2 të Marrëveshjes Hidrokarbure) eliminon efektet negative të Kontraktorit nga zbatimi i Ndryshimeve Fiskale AKQ, në përputhje me objektin e kësaj Marrëveshjeje të Dytë Ndryshuese, sipas nenit 1.2 këtu më sipër.”

6.3 Një paragraf i ri shtohet në nenin 2.22 të aneksit B të Marrëveshjes Hidrokarbure, i cili vendoset menjëherë pas germës “e”, shtohet germa “P”, me përmbajtjen, si më poshtë:

“f) çdo vlerë e taksave që janë përfshirë si pjesë përbërëse e Rregullimeve të Ndryshimeve Fiskale AKQ në zbatim të kësaj Marrëveshjeje të Dytë Ndryshuese, e rimbursuar nga Kontraktori sipas nenit 8.2, të Marrëveshjes së Dytë Ndryshuese;”

6.4 Një paragraf i ri shtohet në nenin 4.2.2 të aneksit B të Marrëveshjes Hidrokarbure, i cili vendoset menjëherë pas germës “P”, shtohet germa “g”, me përmbajtjen si më poshtë:

“g) vlerën e paguar nga Kontraktori për secilën prej taksave (për pjesën e taksës së akcizës, taksës së karbonit dhe taksës së qarkullimit) si pjesë përbërëse të Rregullimeve të Ndryshimeve Fiskale AKQ, dhe që janë përfshirë si Kosto Hidrokarbure, gjatë tremujorit përkatës, dhe të bashkëngjiten faturat dhe/ose dokumentacioni provues për pagesën e vlerës përkatëse;”

6.5 Tabela e shembullit të llogaritjes në nenin 2.10 të aneksit B të Marrëveshjes Hidrokarbure, që fillon me fjalët “Për sqarime të mëtejshme, një shembull i trajtimit” fshihet.

Neni 7

### Aktivitetet për zhvillimin e komunitetit

7.1 Pas nenit 26 të Marrëveshjes Hidrokarbure, shtohet neni 27 me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 27

### Aktivitetet për zhvillimin e komunitetit

27.1 Në përputhje me nenin 8, nenet 2.1 dhe 2.20 të Procedurës së Kontabilitetit dhe nenit 7.2 të Licencë-Marrëveshjes, Kontraktori do të përfshijë në një program dhe buxhet vjetor një përkrahje të përgjithshme dhe kostot e llogaritura, për aktivitetet e zhvillimit të komunitetit që Kontraktori propozon të kryejë në vitin fiskal përkatës si operacione hidrokarbure.

27.2 Jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë para fillimit të çdo tremujori kalendarik, Kontraktori do të përgatisë dhe paraqesë tek Albpetrol dhe në Ministri një pasqyrë ku parashikohen në detaje aktivitetet për zhvillimin e komunitetit të propozuara për t'u kryer nga Kontraktori gjatë tremujorit kalendarik pasardhës, si dhe buxhetin (Programi i Zhvillimit të Komunitetit), dhe Albpetrol dhe Ministria do të informojnë Kontraktorin për çdo ndryshim për t'iu bërë këtij propozimi dhe arsyet brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e tij. Ndryshimet e propozuara mund të bëhen vetëm për atë sa Programi i Zhvillimit të Komunitetit i propozuar: a) tejkalon shumën e përcaktuar në buxhetin përkatës të aprovuar për aktivitetet e zhvillimit të komunitetit; b) nuk është në përputhje me iniciativat për zhvillimin e komunitetit të publikuara nga Qeveria Shqiptare; ose c) nuk është në përputhje me parimet ndërkombëtare të zhvillimit të qëndrueshëm.

27.3 Nëse as Albpetrol, as Ministria nuk e informojnë Kontraktorin për ndonjë ndryshim brenda afatit tridhjetë (30)-ditor në fjalë, ky propozim do të konsiderohet të jetë aprovuar. Nëse ndonjë ndryshim është marrë brenda periudhës në fjalë tridhjetë (30)-ditore, Kontraktori do të marrë në konsideratë këto ndryshime dhe do t'i pasqyrojë ato që i konsideron të nevojshme në një Program për Zhvillimin e Komunitetit të rishikuar. Më pas, Kontraktori do të paraqesë propozimin e rishikuar të Albpetrol dhe në Ministri për aprovim. Nëse asnjë prej tyre nuk e informon Kontraktorin për ndonjë ndryshim shtesë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas kësaj riparaqitjeje, ky



propozim i rishikuar do të konsiderohet i aprovuar.

27.4 Nëse do të ketë mosmarrëveshje rreth ndryshimeve të propozuara, atëherë mosmarrëveshja do të dërgohet për zgjidhje te një ekspert i cili do të caktohet sipas procedurave të parashikuara në nenin 25.4 të Licencë-Marrëveshjes. Eksperti do të përpiqet të gjejë një zgjidhje brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga emërimi i tij. Përpara arritjes së zgjidhjes së ndonjë mosmarrëveshje të tillë, Programi për Zhvillimin e Komunitetit i propozuar nga Kontraktori do të konsiderohet i miratuar për qëllime operacioneve të ndërmjetme në pritje të zgjidhjes.”

Në dëshmi të sa më sipër, Palët kanë nënshkruar këtë Marrëveshje të Dytë Ndryshuese,

që do të hyjë në fuqi nga dita që Këshilli i Ministrave do ta miratojë këtë Marrëveshje të Dytë Ndryshuese.

ALBPETROL SH.A

Përfaqësuar nga:

Funksioni:

BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD.

Përfaqësuar nga:

Funksioni:

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2014

Adresa  
Bulevardi “Gjergj Fishta”,  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,  
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 20 lekë